



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi amerikane (Moduli 2)

Ngarkesa: Katër (4) kredite (= 40 orë mësimore gjithsej): dy (2) kredite leksione (= 20 orë leksione) dhe dy (2) kredite seminare (= 20 orë seminare).

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lënda është e detyrueshme.

Programi i studimit: Bachelor (Gjuhë angleze; Përkthim dhe Interpretim; Studime britanike dhe amerikane)

Kodi i Etikës: Kodin e etikës së UT-së. (nenet 4, 5, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të njohë studentët me sfondin shoqëror dhe kulturor të Letërsisë Moderne dhe Bashkëkohore Amerikane, duke u mbështetur në përvojën e tyre të mëparshme në kursin përkatës; (Letërsia Amerikane - Fillimet e Natyralizmit); Të zgjerojë njohuritë e studentëve për qasjet tradicionale dhe bashkëkohore të letërsisë moderne dhe bashkëkohore amerikane. Të lejojë studentët të eksplorojnë kontekstin estetik, shoqëror dhe politik të periudhës pasi ato reflektohen në disa nga veprat letrare më të famshme të kësaj periudhe; Të zgjerojë njohuritë e studentëve për shkrimtarët e shquar Modernistë dhe Post-modernistë Amerikanë dhe veprat e tyre më kryesore; Të theksojnë njohuritë e tyre analitike në disa vepra specifike letrare.

Rezultatet e pritshme: Në përfundim të kësaj lënde, studenti do të jenë në gjendje:

1. Të analizojë marrëdhënien midis letërsisë amerikane moderne dhe asaj bashkëkohore, si edhe kuadrin historik, politik, shoqëror dhe kulturor të kësaj periudhe;
2. Të diskutojë dhe të shkruajë për mënyrat e ndryshme me anë të të cilave shkrimtarët amerikanë modernistë dhe bashkëkohorë iu qasën çështjeve që lidhen me organizimin e shoqërisë dhe natyrën e identitetit;
3. Të identifikojë dhe të përshkruajë karakteristikat e dallueshme letrare të letërsisë amerikane të shekullit të njëzetë;
4. Të analizojë veprat konkrete letrare, si nga struktura estetike edhe domethënia e tyre, duke i vendosur në kontekstin e duhur historik dhe shoqëror, si edhe duke përdorur terminologjinë e përshtatshme të letërsisë;
5. Të identifikojë dhe diskutojë për çështjet kryesore, konfliktet por edhe për tematikën e disa veprave letrare moderne amerikane të përzgjedhura;